

V E N D I M
Nr. 43, datë 7.2.2002

**PËR PAGESËN E KANDIDATËVE QË PUNËSOHEN NË SHËRBIMIN INFORMATIV
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kandidatët që punësohen në Shërbimin Informativ Shtetëror, pas përfundimit të shkollës së lartë, të paguhet për kohën që vazhdojnë kursin e kualifikimit pranë Institutit të Shërbimit Informativ Shtetëror me pagën minimale të oficerit të SHISH-it.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Shërbimin Informativ Shtetëror.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta